



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al,

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al,

V E N D I M

Nr. 33, datë 30.5.2017

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,
të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.05.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "ë" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", me 28 vota pro,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Merxhan Tula**, meqënëse ka pësuar dëme nga fatkeqësi natyrore. Familja e tij përbëhet prej 4 (katër) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **80,000** (tedhjetëmijë lekë).
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Silvia Rrethi**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
3. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i bashkisë i parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2017 të miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017.
4. Institucioni I bashkisë Shkodër në programin buxhetor 10910 "Emergjencat Civile" ti shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë

shpenzime korente –artikulli 606 “Transferta tek individë”, për t'u përdorur si shpërblim për rastet e fatkeqësisë.



5. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës 180,000 lekë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.5.2017

Shpallur në datën 31.5.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Pr. 5158 dt. 14.06.2017

Nr.644/1.Prot

Shkodër, më 12.06.2017

Lënda: Lidhur me VKB Shkoder Nr.33 dt.30.05.2017.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të ligjit Nr.107/2016 Dt 27.10.2016 "Për Prefektin", analizo vendimin Nr.33 datë 30.05.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Mbi dhënien e ndihmës financiare, marre nga buxheti i bashkise Shkoder 2017 për familjet që kanë pesuar dëme të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (termet) Z.Merxhan Tula sipas procesverbalit të konstatimit të ngjarjes të dates 10.04.2017 ne shumën 80.000 leke dhe Znj.Silvia Rrethi ne shumën 100.000 leke sipas procesverbalit të konstatimit të ngjarjeve të dt.18.04.2017 dhe vërtetimeve të MZSH-së bashkëlidhurte dates 4 Mars 2017):.

Prefekti i Qarkut Shkodër, bazuar ne ligjin nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 29, neni 54, germa dh, neni 55/3, neni 64, germa c, ligjit Nr.8756, dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar, ligjit Nr.130/2016 dt.15.12.2016 "Per buxhetin e vitit 2017", Ligjit nr.9936 dt.26.06. 2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar, neni 17, Udhezimit te Ministrise se Financave nr.8 dt.13.01.2017 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2017", Udhezimit Nr.263 dt.24.05.2013 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore Financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vkb Shkoder nr.8 dt.30.01.2017 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2017", ju autorizon te procedoni ne reference te Kreut III, pika 1, germa e e VKM Nr.329 dt. 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Me respekt,

PREFEKTI

